

Ne fokus/ Kombetarja feston fundivitin ne Shqiperi

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 23 Dhjetor 2013 20:17



Lojtaret e Kombetares jane rikthyer ne shtepi. Shume nga futbollistet qe luajne ne Europe dhe me larg kane zgjedhur te pushojne ne Shqiperi. Hamdi Salihi eshte rikthyer ne Shkoder, Bogdani ne Tirane, Hyka ne Tirane, te tjere kane shkuar ne Selanik fillimisht tek fejesa e Kristi Vangjelit dhe shume shpejt do te jene ne Tirane e ne qytet e tyre te lindjes per te pushuar per festat e fundvitit. Legjionaret shqiptare jane rikthyer dhe sapo e kane bere kete kane marre vemendjen e tifozeve kuqezi qe kane nisur te postojne foto te ndryshme qe kane shkrepur keto dite me to.